




REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO
 AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
 AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
 ANTI-CORRUPTION AGENCY

Dep. 2-D/DPK
 Dep. 01-194/15
 Nr. l faq. 02
 Broj stranica 02
 Nr. pages 02

Nr. Prot. 01-194/15
 Br. Prot. 01-194/15
 Prot No. 01-194/15
 Data 26-01-2015
 Datum 26-01-2015
 Date 26-01-2015

PRISHTINË



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	22.01.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK
PËR/ZA/TO:	z. Zef Prendrecaj Drejtor - Zyra e Prokurorit Disiplinor (ZPD)
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin të funksionit publik



I nderuari z. Prendrecaj,

Lidhur me kërkesën tuaj drejtuar Agjencisë kundër Korrupsionit (DPK-03-4735/14), për shqyrtimin e konfliktit të interesit në rastin kur vajza e Kryetarit të Komisionit Disiplinor z. Jetish Maloku, është pranuar bashkëpunëtorë profesionale në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZPD), ju njoftojmë se në kuadër të kompetencave të Agjencisë kundër Korrupsionit lidhur me konfliktin e interesit, sipas Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, Agjencia, ndër të tjera, "bënë këshillimin e zyrtarëve të lartë të veçantë, të eprorëve, të institucioneve eprorë, me kërkesën e tyre, për raste të caktuara të shfaqjes së konfliktit të interesave, dhe për çështje të etikës të lidhura me to, si dhe me regjistrimin rast për rast të interesave", si dhe ofron opinione dhe ndërmerr të gjitha masat tjera ligjore me qëllim të parandalimit të konfliktit të interesit dhe të korrupsionit në tërësi. (Neni 19, pika 1.5, dhe 1.6 të Ligjit Nr.04/L-051). Prandaj, në bazë të kësaj, ofrojmë këtë:

OPINION

Nuk ka konflikt faktik të interesit në rastin e pranimit të kandidatës znj. Ilirjana Krasniqi-Maloku për pozitën e bashkëpunëtores profesionale në Zyrën e Prokurorit Disiplinor.

A r s y e t i m

Bazuar në kërkesën zyrtare të z. Zef Prendrecaj (Drejtor i Zyres së Prokurorit Disiplinor), për shqyrtimin e konfliktit të interesit në rastin kur vajza e Kryetarit të Komisionit Disiplinor z. Jetish Maloku, përkatësisht Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan dhe Anëtarit të Këshillit Prokurorial të Kosovës është pranuar bashkëpunëtoresh profesionale në Zyrën e Prokurorit Disiplinor (ZPD), Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, në këtë situatë, nuk ka paraparë ndonjë dispozitë kufizuese.

Në bazë të këtij ligji, konflikti i interesit do të ekzistonte sikur z. Jetish Maloku do të ishte pjesë e komisionit të vlerësimit të kandidatëve për këtë pozitë. Ndërsa, në bazë të informacioneve që kemi marrë nga z. Prendrecaj, z. Maloku nuk ka marrë pjesë në asnjë fazë të procesit të përzgjedhjes së kandidatëve. Intervistimin e kandidatëve për këtë pozitë e kanë bërë tre anëtarë nga Zyra e Prokurorit Disiplinor dhe dy të tjerë nga Sekretariati i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Analizimi i këtij rasti ka vazhduar edhe më tutje për të shikuar nëse, për shkak të lidhjes familjare, njëri nga zyrtarët mund të bie në konflikt “rast për rast” të interesit.

Konflikti “rast për rast” mund të shfaqej në situatën kur znj. Ilirjana Krasniqi-Maloku, në kuadër të kompetencave, mbledh informata për lëndët e prokurorëve dhe këto lëndë procedohen në Komisionin Disiplinor, në të cilin z. Jetish Maloku është kryetar.

Pika 1 e nenit 13 të ligjit PKI përcakton se *“Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publik, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”*.

Në këtë situatë, njëri prej zyrtarëve ka për obligim që ta bëjë deklarimin “rast për rast” të konfliktit të interesit dhe të tërhiqet nga vendimmarrja. Mënyra e shmangies së kësaj situatë është parashikuar edhe me Kodin e Etikes dhe Sjelljes Profesionale.

Mirëpo, duke qenë se z. Prendrecaj na ka informuar se znj. Krasniqi Maloku, prej që ka filluar punën në ZPD, është ngarkuar vetëm me rastet e gjyqtarëve dhe nuk ka punuar asnjë rast të prokurorëve nga Prokuroritë e Kosovës, do të thotë se, edhe paraprakisht janë parandaluar situatat e mundshme të konfliktit të interesit.

Me respekt!